URDHËR
Nr. 282, datë 11.11.2024

PËR DISA SHTESA NË URDHRIN E MINISTRIT NR. 170, DATË 13.9.2022, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, QË LIDHEN ME AERODROMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 10, të nenit 54, të ligjit nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa shtesave në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin e ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë", miratuar me urdhrin e ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në Nenin 2 "Përkufizime", bëhet shtesat si më poshtë vijon:

"16. Vlera e klasifikimit të avionit (ACR) nënkupton një numër që shpreh efektin relativ të një avioni në sipërfaqe të shtruar për një nënkategori të specifikuar standarde.

Shënim. Numri i klasifikimit të avionit llogaritet në lidhje me pozicionin e qendrës së gravitetit (CG) që jep ngarkesën kritike në rrotat kryesore. Normalisht, pozicioni më i lartë CG i përshtatshëm në masën maksimale të platformës (terren) është përdorur për të llogaritur ACN-në. Në raste të veçanta, pozicioni i CG-së përpara duhet të rezultojë në ushtrimin e ngarkesës në rrotën e hundës duke qenë më kritike.

17. Vlera e klasifikimit të fortësisë së sipërfaqes së shtruar (PCR) nënkupton një numër që shpreh kapacitetin e forcës mbajtëse të një sipërfaqeje të shtruar."

2. Në aneksin IV, pjesa Kërkesat operacionale – Aerodromet (pjesa-ADR.OPS), nënpjesa A – Të dhënat e aerodromit (ADR.OPS.A), pas paragrafit ADR.OPS.A.057 bëhet shtesa si më poshtë vijon:

"ADR OPS.A.058 Fortësia e sipërfaqes së shtruar (e zbatueshme nga data 28 nëntor 2024)

1. Forca mbajtëse e sipërfaqes së shtruar duhet të përcaktohet nga operatori i aerodromit.
2. Forca mbajtëse e sipërfaqes së shtruar të destinuar, për avionët me masë më të madhe se 5 700 kg, duhet të vihet në dispozicion, duke përdorur vlerën e klasifikimit të avionit – vlerën e klasifikimit të sipërfaqes së shtruar (ACR-PCR), duke raportuar të gjithë informacionin e mëposhtëm:

a) vlera e klasifikimit të sipërfaqes së shtruar (PCR) dhe vlera numerike;
b) tipi i sipërfaqes së shtruar për përcaktimin e ACR-PCR;
c) kategoria e forcës së nënshtresave;

d) kategoria maksimale e lejuar e presionit të gomave ose vlera maksimale e lejuar e presionit të gomave; dhe

e) metoda e vlerësimit.

Shënim. Udhëzime për raportimin dhe publikimin e PCR-ve mund të gjenden në Manualin e Projektimit të Aerodromit (dok. 9157).

3. Vlera e klasifikimit të sipërfaqes së shtruar (PCR) duhet të tregojë se një avion me vlerë të klasifikimit të avionit (ACR) të barabartë ose më të ulët se PCR-ja e raportuar mund të operojë në dysheme, duke iu nënshtruar çdo kufizimi mbi presionin e gomave ose masën totale të avionëve për tip/at e avionit të specifikuar.

Shënim. PCR të ndryshme mund të raportohen nëse forca e sipërfaqes së shtruar është subjekt i një ndryshimi të konsiderueshëm sezonal.

4. ACR-ja e një avioni përcaktohet në përputhje me procedurat standarde të lidhura me metodën ACR-PCR.

Shënim. Procedurat standarde për përcaktimin e ACR-së së një avioni janë dhënë në Manualin e Projektimit të Aerodromit (dok. 9157); pjesa 3. Për lehtësi, software të dedikuar mund të gjenden në website-in e ICAO-s, për llogaritjen e çdo ACR-je avioni në çdo masë në sipërfaqe të shtresës së ngurtë dhe fleksibël për katër kategoritë standarde të forcës së nënshtresës.

5. Për qëllimet e përcaktimit të ACR-së, reagimi i një sipërfaqeje piste duhet të klasifikohet si ekuivalent ndaj një ndërtimi të ngurtë ose fleksibël.

6. Informacioni mbi llojin e sipërfaqes për përcaktimin e ACR-PCR, kategoria e forcës së nënshtresave, kategoria maksimale e lejuar e presionit të gomave dhe metoda e vlerësimit duhet të raportohet duke përdorur kodet e mëposhtme:

a) Tipi i sipërfaqes për përcaktimin e ACR-PCR:

	Kodi
Sipërfaqe e ngurtë	R
Sipërfaqe fleksibël	F

b) Llojet e kategorive sipas fortësisë:

	Kodi
Fortësi e lartë: Karakterizohet nga E = 200 MPa dhe përfaqëson të gjitha vlerat E të barabarta ose më të larta se 150 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	A
Fortësi mesatare: Karakterizohet nga E = 120 MPa dhe përfaqëson një game të të gjitha vlerave E të barabarta ose më të larta se 100 MPa dhe më të ulëta se 150 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	B
Fortësi e ulët: Karakterizohet nga E = 120 MPa dhe përfaqëson një gamë të të gjitha vlerave E të barabarta ose më të larta se 100 MPa dhe më të ulëta se 150 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	C
Fortësi ultra e ulët: Karakterizohet nga E = 50 MPa dhe përfaqëson të gjithë vlerat E më të ulëta se 60 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	D

c) Kategoria maksimale e lejuar e presionit të gomave:

	Kodi
E pakufizuar: Presion pa kufizim	W
E lartë: Presioni i kufizuar deri në 1.75 MPa	X
Mesatare: Presioni i kufizuar deri në 1.25 MPa	Y
E ulët: Presioni i kufizuar deri në 0.50 MPa	Z

d) Metoda e vlerësimit:

	Kodi
Vlerësimi teknik: përfaqëson një studim specifik të karakteristikave të sipërfaqes dhe tipat e	

avionëve për të cilët është destinuar të përdoret kjo sipërfaqe	T
Duke përdorur eksperiencën e avionëve: që përfaqëson një njohuri të llojit dhe masës specifike të avionëve që mbahen në mënyrë të kënaqshme në përdorim të rregullt	U

Shënim. Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë sesi të dhënat e fortësisë të sipërfaqeve raportohen sipas metodës ACR-PCR. Udhëzime të mëtejshme për këtë temë gjenden në Manualin e Projektimit të Aerodromit (dok. 9157), pjesa 3 – Sipërfaqet.

Shembull 1. Nëse forca mbështetëse e një sipërfaqeje të ngurtë, që mbështetet në një bazë të mesme fortësie, është gjykuar nga vlerësimi teknik për të qenë PCR 760 dhe nuk ka kufizim të presionit të gomave, atëherë informacioni i raportuar do të ishte:

PCR 760 /R/B/W/T

Shembull 2. Nëse forca mbajtëse e një sipërfaqeje të përbërë, që është shtrirë si një dysheme fleksibël dhe duke u mbështetur në një nënndarje të fortë, është vlerësuar duke përdorur eksperiencën e aeroplanëve për të qenë PCR 550 dhe presioni maksimal i lejuar i gomave është 1.25 MPa, më pas informacioni i raportuar do të jetë:

PCR 550 /F/A/Y/U

Shënim. Material ndërtim i përzier.

7. Forca mbajtëse e një sipërfaqeje të destinuar për avionët e masës së platformës (VQA) të barabartë me ose më pak se 5 700 kg do të vihen në dispozicion, duke raportuar informacionin e mëposhtëm:

a) Masa maksimale e lejuar e avionëve; dhe

b) Maksimumi i lejuar i presionit të gomave.

Shembull. 4 800 kg/0.60 MPa.”